

UDHA ISLAMIE

Viti XIII - Nr. 8 (150), Gusht, 2015

E përnuajshme Informativ - Fetare - Kulturore - Edukative

Botim i Myftinisë Shkodër

150 numru

Udhë Islame



UDHA ISLAMIE
 Viti XIII - Nr. 8 (150) - Gusht 2015
 Botim i Myftinisë Shkodër

URIM DHE LUTJE PËR MË NUMRIN 100 TË GAZETES

U PREZANTUA
 Mënyra e shkollimit
 Nën drejtimin e Mehmetit

E XHUMAJA NR. 2
 Ditë e re në xhumë...
 Mënyra e shkollimit...
 Nën drejtimin e Mehmetit...

UDHA ISLAMIE
 Botim i Myftinisë Shkodër
 REXHEP - 1423
 Tetor - 2002
 Viti i parë i botimit / Nr. 1

Në duart tuaja edhe gazeta "Udhë Islame"

Përkëndetja
 Botimi i gazetës "Udhë Islame" me 150 numra, është një ngjarje me rëndësi të madhe dhe e merituar për kulturën islame në vendin tonë. Për këtë përjetësi përmendim në mënyrë të veçantë të gjithë ata që kanë kontribuar në realizimin e kësaj punë të vështirë dhe të lumenjtë. Botimi i kësaj gazetë është një detyrë e shenjtë për kulturën dhe shpirtërorinë e shqiptarëve, krijon një llojësi të re të kulturës.

Udhë Islame

Në këtë numër do të lexoni:

- Baza kryesore e përparimit të përgjithshëm / faqe 4
- Biblioteka e Myftinisë së Shkodërës në krijim dhe sipër / faqe 5
- Në gjurmët e dijetarëve / faqe 6
- Në shaminë e Farrucit përkrëjtjet me madhësitë Mesud Shehri / faqe 7
- Më shumë se një kompliment për krijimtariën e Muhamedit Sytari / faqe 8
- U organizua simpoziumi me temë "Muhamedi a.s. shembull për të gjithë besimtarët" / faqe 10
- Medresistëve / faqe 11
- Gazeta beta Islame

MYFTIU I SHKODËRËS
 Haxhi Fikri Hashe

Botim i



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë vetëm All-llahut, Zotit të vetëm të botëve, i Cili na udhëzoi drejt punës dhe sakrificës në jetë, për të jetuar me bekimet e Tij dhe për ta shijuar hallallin e pasurisë, që vjen nga rizku i Tij. Thotë në Kur'anin Famëlartë: “Ai është që tokën jua bëri të përshtatshme, prandaj ecni nëpër pjesë të saj dhe shfrytëzoni begatitë e Tij”¹

Salavatet dhe selamet më të përzemërta, ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo ditë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), i cili lutej: “All-llahumme më ruaj nga paaftësia për të punuar dhe nga dembelizmi...”²

TË NDERUAR, MOTRA DHE VËLLEZËR BESIMTARË,

Një prej temave të neglizhuara kohëve të fundit në realitetet e jetës tonë të përditshme, është pa dyshim edhe puna, angazhimi për të fituar nga hallalli i duarve dhe sakrifica për familjen dhe komunitetin.

Po lexoja një trajtim shumë interesant, që dijetari bashkëkohor, Shejkh Ali Esh-Sherbexhi i bën vlerës që ka shfrytëzimi i kohës në jetën e muslimanit në drejtim të punës, fitimit të hallallit, prodhimit, shfrytëzimit të mundësive të shumta, për të bërë diçka të dobishme në jetë.

Ndër të tjera, ai thekson: “Fitimi

1. Kur’ani, El-Mulk: 15.

2. Imam Hakimi dhe Bejhekiu, në një hadith të gjatë të transmetuar nga Enesi (r.a).

“ALL-LLAHUMME MË RUAJ NGA PAAFTËSIA PËR TË PUNUAR DHE NGA DEMBELIZMI..!”

hallall dhe kërkimi i rizkut nga burimet e tij legjitime, është një urdhëresë e detyruar për muslimanin e pjekur, sepse nëpërmjet punës ai arrin të mjaftojë veten, familjen, si dhe të shtrijë dorën e ndihmës ndaj nevojtarit e skamnorit. Jo vetëm kaq, por edhe të kontribuojë në zhvillimin e resurseve të vendit të tij, lulëzimin e jetës dhe realizimin e mirëqenies!”³

Nga këtu, nuk ka sesi të mos gëzohemi dhe të mbushemi me optimizëm për të sotmen dhe të ardhmen, kur Resulull-llahu (a.s) na jep sihariq se: “Ai që del të punojë për të ushqyer fëmijët e tij të vegjël, është në rrugën e All-llahut. Edhe nëse del të punojë për të ushqyer dy prindit e tij të moshuar, është në rrugën e All-llahut. Edhe nëse del të punojë për të ruajtur veten e tij nga harami, është në rrugën e All-llahut. Ndërsa ai që del të punojë për të rënë në sytë e tjerëve, a për t’u mburrur (plot egoizëm) me punën e tij, ai është në rrugën e shejtanit!”⁴

TË DASHUR TË PRANISHËM,

Feja jonë islame na edukon me frymën e punës dhe sakrificës në jetë. Transmetohet se Hz. Omeri (r.a) i kishte thënë një ditë disa të rinjve: “Mos të frenohet ndonjëri prej jush nga kërkimi i rizkut, duke thënë: “All-llahumme më furnizo me rizk”, sepse ju e dini se nga qielli nuk bie as ar, as argjend!”⁵

E kishte thënë këtë, jo për të ndaluar lutjet, jo, aspak! Por, për t’i edukuar të rinjtë se puna dhe angazhimi për të fituar rizkun hallall është një mirësi e madhe, që e bën

3. Shejkh Ali Esh-Sherbexhi, “El-erbaunel-mukhtare fil-fedailid-diniijeti vel-insaniije”, botimi i parë, Kuvajt, 2006, f. 394.

4. Transmetuar nga Imam Tabaraniu, ndërsa Mundhiru ka thënë: “Burrat e zinxhirit të tij, janë burra të hadithit të saktë”.

5. Imam Shihabuddin ibn Muhammed El-Ebshihi, “El-Mustatraf fi kul-li fennin mustadhruf”, Beirut, 1981, f. 304.

njeriun të jetojë me nder e krenari në jetën e tij.

Për këtë, Resulull-llahu (a.s) thoshte: “Ku ka njeri me shpërblim më të madh sesa ai që shpenzon për fëmijët e tij të vegjël, duke i mbrojtur

“Ai që del të punojë për të ushqyer fëmijët e tij të vegjël, është në rrugën e All-llahut. Edhe nëse del të punojë për të ushqyer dy prindit e tij të moshuar, është në rrugën e All-llahut. Edhe nëse del të punojë për të ruajtur veten e tij nga harami, është në rrugën e All-llahut. Ndërsa ai që del të punojë për të rënë në sytë e tjerëve, a për t’u mburrur (plot egoizëm) me punën e tij, ai është në rrugën e shejtanit!”

nga harami? U sjell All-llahu dobi prej punës së tij dhe i mjafton.”⁶ Pra, i ushqen nga puna e duarve të tij dhe i mjafton nga uria, etja, dhe nevojat që kanë.

Sot, është e nevojshme që të rinjtë muslimanë të mos e humbin kohën e

6. Transmetuar nga Imam Muslimi, nga Ebu Kilabe (r.a).

tyre, pa dobi, por të angazhohen e të sakrifkohen në kërkim të hallallit. Sepse ai që punon dhe mbështetet në All-llahun, ai do të ketë sukses dhe mbarësi në jetë. Do të punojë pastër, do të fitojë pastër, do të shpenzojë nga pasuria e tij dhe nëpërmjet saj do të arrijë kënaqësinë e Zotit!

Ka shumë të rinj, në ditët tona, që sillen vërdallë, pa punë, pa dritë shprese, plot pesimizëm e shpesh edhe demoralizim, nga mungesa e politikave të punës dhe zhvillimit të begative, me të cilat Zoti e begatuar këtë vend.

Nga ana tjetër, ka shumë të rinj muslimanë, të cilët janë përkushtuar në zanate e punë të ndryshme, kanë hapur biznese, sado të vogla qofshin. Shpesh, këto biznese i etiketojnë edhe me termin “hallall”. Natyrshëm, muslimani nuk punon vetëm se hallall, pastër e ndershëm.

Por, ndoshta, meqë haramet janë përhapur gjithandej dhe fatkeqësisht edhe në bizneset e shumë muslimanëve me emër, këta të rinj janë detyruar të specifkohen se puna e tyre është brenda kufijve të hallallit. Për këtë, ata duhet të jenë të kujdesshëm dyfish. Së pari, për vetë punën dhe zanatin e tyre. Së dyti, për të justifikuar me nder dhe krenari termin “hallall”, që ia shoqërojnë bizneseve dhe zanateve të tyre, Zoti u dhashtë të mbarën!

Sepse ai që hap një biznes dhe i paraprin emrit të zanatit të tij me fjalën “hallall”, nëse nuk është korrekt me veten dhe etikën islame në punë, ai është më i dëmshëm se pala e parë. Më qëlloi një ditë të hy në një biznes “hallall”. Punëtori i parë që më doli në ballë, ishte veshur me pantallona të shkurtra, përtej kufirit të auresit, mbante një cigare në gojë, teksa shijonte një këngë që dëgjohej në sfond nga një manjetofon i hapur, me zë të lartë...!?

TË DASHURIT E MI,

Fryma e punës dhe e dobisë nëpërmjet saj, qëndron në themelet e edukatës së muslimanit. Resulull-

llahu (a.s) thoshte: “Cilido musliman që mbjell një fidan, apo një arë, prej së cilës ushqehet zogu, njeriu a bagëtia, atij do t’i regjistrohet si sadeka.”⁷

Lexova para disa ditësh se një fshatar, në një zonë të Turqisë, kishte vendosur një tabelë të madhe në një cep të arës së tij, ku kishte mbjellur lloj-lloj frutash. Në të shkruhej: “Kushdo që kalon nga kjo arë dhe ha diçka prej saj, e ka hallall”. Subhanallah, sa bukur. I lumi ai!

Në tregjet e Damaskut, në shumë tezga, ku shkon të blesh, do të gjesh tabela të vogla të vendosura mbi mallrat e larmishme, ku shënohet: “Provoje, e ke hallall”!

Prandaj, mesazhi im i kësaj jave i kushtohet pikërisht nxitjes për të punuar, për të fituar zanate, për të kërkuar punë, për të dhënë shembullin tonë si muslimanë nëpërmjet punës dhe sakrificës në të.

U them shumë të rinjve besimtarë: Shkoni dhe mësoni zanate si: gdhendja në dru, punimi i gurit, zdrukthëtaria, punimi i hekurit, rrobaqepësia speciale, imtësitë e elektronikës, kuzhina.

Hapni lokale dhe restorante, pa pije dhe ushqime të ndaluara dhe, servirni bukur dhe me shije atë që kërkojnë klientët. Hapni punishta ëmbëlsirash, sera lulesh etj, por, çdo gjë që të bëni, bëjeni me shpirt, me plot përkushtim, respektojeni klientin dhe nderojeni atë. Mos e lini të presë atë që ju ka ardhur në punishte, në dyqan, në lokal, në restorant a kudo qoftë puna e juaj!

Dhe, asnjëherë të mos kini turp nga ajo që bëni, sepse çfarëdo që të bëni në jetë, shoqëruar me besim dhe frikën e Zotit, është punë e pastër, punë e hajrit, punë që të nderon.

Për këtë, Resulull-llahu (a.s) udhëzonte: “Pasha Atë, që e ka shpirtin tim në dorën e Tij, të marrë ndonjëri prej jush litarët e tij dhe të lidhë drunj mbi shpinë, është më e mirë për të sesa të shkojë e të lypë nga njerëzit; dikush i jep e dikush jo!”⁸

7. Transmetuar nga Bukhari dhe Muslimi.

8. Transmetuar nga Bukhari.

MESAZHI IM I KËSAJ JAVE
I KUSHTOHET PIKËRISHT
NIXITJES PËR TË PUNUAR,
PËR TË FITUAR ZANATE,
PËR TË KËRKUAR PUNË,
PËR TË DHËNË SHEMBULLIN
TONË SI MUSLIMANË
NËPËRMJET PUNËS
DHE SAKRIFICËS NË TË.

Gjithashtu, thoshte: “Janë disa gjynahe që nuk i fshin as namazi, as agjërimi, as haxhi, as umreja, por i fshin shqetësimi për kërkimin e jetesës!”⁹

Më lejoni ta përfundoj me një shembull të mrekullueshëm nga nëna e jonë, Zejneb bint Xhahsh (r.a) dhe lidhja e saj me hadithin: “Ajo që më së shpejti do më ndjekë nga kjo botë, është më bamirësja ndër ju!”¹⁰

H.z. Aishja (r.a), nëna e besimtarëve, tregon se: “... E para grua që ndërroi jetë pas Resulull-llahut (a.s), ishte Zejneb bint Xhahsh (r.a)... Ajo punonte me duart e saj lëkurat dhe jepte sadeka.”¹¹

All-llahumme na bëj prej atyre që dëgjojnë fjalën dhe veprojnë më të mirën e saj.

Vel-hamdulil-lahi rabbil-alemine!

(Hytbe e mbajtur
në xhaminë e Perashit)

Shkodër, më 31 korrik 2015

9. Transmetuar nga Ebu Nuajmi në “El-Hilje” dhe Ibn Asakir, nga Ebu Hurejra (r.a). Imam Sujuti e ka regjistruar në “El-Xhamiu-Sagir”, me nr. 2461.

10. Transmetuar nga Bukhari, nga Aishja (r.a).

11. Nedhir Mektebi, “Safahatun nejjiratun min hajatis-sabikat”, botimi i dytë, Bejrut, 1996, f. 157. (Me përshtatje të lehtë të dy transmetimeve të ngjarjes. M.S.)



Dr. Mustafa Mahmud

A ke menduar ndonjëherë rreth vetes tënde?

Rreth trupit tënd dhe, se si punon?

Shkencat e anatomisë dhe psikologjisë na i kanë hapur sytë mbi mrekullitë dhe mahnitë, përpara të cilave mendja qëndron e shtangur.

Tani e dimë mirë, me përlogaritje dhe shifra, se në dy mushkëritë ekzistojnë mjete për pastrimin e gjakut dhe ajrosjes së tij, shtatë fish më shumë se nevoja jonë për frymëmarrje...

E njëjta gjë edhe për dy veshkat, në të cilat ka rezerva shtatë herë më shumë se sa nevojë e duhur për të siguruar jetën...

Këtë bujari dhe mirësi e gjejmë gjithashtu edhe në ndërtimin e mëlçisë dhe muskujt e zemrës, në rruazat e kuqe dhe në rruazat e bardha...

Këtu fuqia e Krijuesit, urtësia dhe dashuria e Tij janë të shtrira deri në pafundësi. Anatomia na bën të ditur se nervat e syrit kanë më shumë se një milion fije nervore, ku të gjitha ndërthuren për të krijuar rrjetën, e cila është edhe gropa e syrit. Në të bie pamja dhe arrihet fotografimi i saj me një cilësi tepër të lartë, duke parë në terr dhe nganjëherë edhe në errësi, dallojmë nuancat e një ngjyre të vetme dhe mes përzierjeve të saj, çfarë të të mahnitë.

Ndërsa, aftësia e veshit për të dalluar nivelin e zërit dhe llojin e tij, ia kalon mrekullisë së syrit. Nëna mund të jetë e paaftë të dallojë fytyrën e fëmijës së saj të humbur në turmë, por ajo mundet të dallojë zërin e të qarit të tij, në mes të një mijë zërave...

FUQIA E ALL-LLAHUT

E, nëse arrijmë tek truri, atëherë ne jemi përpara të jashtëzakonshmes së papërshkruar. Këtu është vendtakimi i fijeve nervore, të ngjashme me një çelës gjigant, në të cilin takohen më shumë se njëqind milionë fije nervore. Të gjitha punojnë së bashku dhe në të njëjtën kohë marrin mesazhe, i analizojnë dhe u kthejnë përgjigje...

Në çdo moment arrijnë në tru ujëvara perceptimesh nga lëkura, organet, syri dhe veshi, e në të njëjtën kohë prej vet trurit dalin, po në të njëjtin moment, tufane përgjigjesh në kabllo nervore, që dërgojnë çdo përgjigje në vendin e saj.

Të gjithë muskujt dërgojnë në tru, në po atë moment hollësi tepër të sakta për çfarë u ka ndodhur prej tensionit, tkurrjes, apo mos ngacimit dhe truri duhet tu kthejë përgjigje, në të njëjtin moment me të dhënat e kërkuara për të arritur tek çfarëdo situatë që duam... me këtë gjë ne mundemi të qëndrojmë me kokë poshtë, të ecim mbi duar, apo të ruajmë ekuilibrin me një këmbë, pa u rrëzuar.

Kështu ne gjejmë se procesi i ruajtjes së ekuilibrit është i ndërlikuar prej njëmijë kontrolleve. Çdo muskul ka tru elektronik të vogël dhe qendër

organizmi në tru (kokë). Qendrat e ndryshme kanë sallën operacionale, e cila i organizon të tëra, pastaj e gjitha kjo i nënshtrohet vullnetit dhe zgjedhjes së lirë.

Nëse pohojmë se mbi trurin është diçka më e madhe, e kjo është mendja dhe se truri nuk është, vetëm se ana mekanike e procesit tepër misterioz.

Dhe se mendja, ajo është padronia. Ajo është, e cila urdhëron dhe ajo është, e cila flet pas këtij çelësi të habitshëm... ne më në fund, jemi përpara një mrekullie më të madhe.

Kjo mendje, me të cilën luftuam mikrobet, zbutëm luanët, gjuajmë lepujt dhe nënshtroam egërsirat e pyjeve...

Kjo mendje, me të cilën ndërtoam piramidat dhe digat, shkulëm malet prej vendeve të tyre, rrëzuam perandori dhe ngritën të tjera... dhe së fundmi u ngjitëm në hënë dhe lundruam nëpër yje.

Ja, pra ne, sa herë që zbulojmë një mrekulli prej mrekullive të bujarisë së Krijuesit, na udhëheq meditimi i kësaj bujarie drejt një bujarie më të madhe dhe dhuntie edhe më të madhe.

E, pas mendjes, meditimi na udhëheq drejt shpirtit... misteri i mistereve dhe kulmi i dhuntisë mëshironjëse.

Këtu, lapsi është i paaftë dhe mendja heshtë prej turpit, përpara begatisë, ku imagjinata nuk zotëron asgjë për ta përshkruar. Pasi, Krijuesi e përshkruan, se ai ka dalë prej Tij dhe thotë për krijimin e Ademit (a.s): "E, kur t'i fryjë në të prej shpirtit Tim, bjerini në sexhde". Ai (shpirti) është drita e dritës së Tij. I Lartmadhëruar dhe i Madhëruar në qiejt e Tij, i Cili na krijoi me Emrin e Tij, Bujar, Dhurues dhe dhuntitë e Tij arritën kulmin e nuk mund të numërohen. Nuk mundet laps ta përkufizojë, apo ta llogarisë bujarinë dhe punët e Tij...

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja

*E, pas mendjes,
meditimi na udhëheq
drejt shpirtit...
misteri i mistereve
dhe kulmi i dhuntisë
mëshironjëse.
Këtu, lapsi është i paaftë
dhe mendja heshtë
prej turpit,
përpara begatisë,
ku imagjinata nuk zotëron
asgjë për ta përshkruar.*



Xhahid Bushati, *shkrimtar*

KUJTIME FËMIJËRIE...

kam bërë me të... (Ai ishte verbuar në moshën 2-vjeçare). Nga kërkimet e mia kam mësuar se Hafiz Qazimi ka lindur, më 15.10.1819 në lagjen “Dërgut”. Vdiq, më 15.10.1991.

Hafiz Qazimi ka lindur në atë shtëpi, ku kanë banuar Shuqo, Rexhep e Fadil Rakiqi. Ishte një shtëpi dykatshe, me mur guri dhe, edhe sot është në gjendje të mirë. Ka pasur komshi Haxhi Hafiz Ibrahim Kadukun, një personalitet fetar dhe me mjaft influencë në Shkodër.

Hafiz Qazimit, ia kultivuan fenë në shpirt dy prindërit e tij: Zeneli e Nefetja. Mësimet e para fetare i mori në Mejtepin e Xhamisë Plakë, ku mësues të parë ka patur Molla Brahim Dibrën, e më vonë Hafiz Ymer Bakallin. Nga mosha 20 vjeç deri në vitin 1967 (kur fatkeqësisht e mizorisht u mbyllën xhamitë), ushtroi aktivitetin si muezin në Xhaminë Plakë. Ka pasur një zë të bukur, shumë të bukur!.. Përmendësh ka ditur Kur’anin. E këndonte bukur! Dhe unë jam një nga ata dëshmitarë. Emocione na dhuronte. Seç kishte një magji zëri i tij si prej bilbili!.. Eh, Hafiz Qazim, Hafiz Qazim!..

Dhe... kur u hap Xhamia e Plumbit, ndoshta Hafiz Qazimi ishte njëri nga udhëtarët-besimtarë jo të zakonshëm. Me dritën e syve në shpirt ai udhëtoi (sigurisht me bashkëshoqërues) drejt asaj ëndrrë të fshehur e të kahershme që më në fund u bë realitet. Po shkante drejt Xhamisë së Plumbit për t’u falur. Po shkante siç e kishte zakon: I heshtur e me hap të shpejtë. E për këtë tha: “Tashti po të vdes, jam i lumtur, meqë arrita të këndoja përsëri në Xhami...”

Rrugica kishte dhe një kthesë. Në të djathtë të kthesës, pas familjes Shiroka, vinin Pukejt. Me familjen time na ndante një mur, nga ana e oborrit. Kumbulla e tyre binte nga ana jonë, por që nuk u prek kurrë. Në atë shtëpi që ishte në formën e germës L, vite më parë kishte jetuar Hafiz Halil Puka një dijetar i mençur. Me vonë e mësova se kishte qenë shok i ngushtë me gjyshin tim Hafiz Halid Bushatin. Kaq e ngushtë dhe e ndritur kishte qenë kjo shoqëri e miqësi hoxhallarësh, sa

gjyshin im e kishte lënë me amanet: “Të më varrosni te Xhamia Plakë”, aty ku hoxhë është Hafiz Halil Puka.” Sigurisht, po vonë, e mësova se ku kishte qenë dhe varri i gjyshit tim mendjendritur prej dijetari.

Po në këtë familje jetonte edhe Hysni Puka. Një zëbilbil i Xhamisë së Parrucës. Ishte muezini i saj. Një burrë popullor, plot humor dhe tip sportiv. Nuk përtonte te hynte në lojë me ne. Këtë e bënte shpesh. Nuk i harronim edhe përkëdheljet e dashamirësitë e tij.

Jo larg kësaj rrugice, ishte Xhamia Plakë. Pranë oborrit të saj kalonim një pjesë të fëmijërisë sonë. Këtu njoha dhe Hafiz Manin. I dukej pleqëria. Nuk i mungonte buzëqeshja. Edhe kërrusjen e kishte të bukur!.. Gjithashtu këtu njoha edhe Hafiz Sabri Koçin. Ishte Hoxha i kësaj Xhamie. Edhe sot e kësaj dite më sillet nëpërmend figura e tij. Kam besuar se, ishte një Hoxhë që vinte nga “Universiteti i Jetës”. Me urtësinë, përvojën, elekuencën dhe diturinë e kësaj shkolle, që jo çdokush e përvetëson; rrezatonte BESIMIN ISLAM. Një ditë, nuk e pamë më. U trishtuam. Na u mbushën sytë me lot. Ndoshta, po, po, ishte më se e vërtetë: Po afronte një tufan i llahtarshëm, egërshan. Ai, një ditë, i prishi edhe lojërat tona, fëmijërinë dhe ëndrrat. Ai prishi xhamitë, dhe Xhaminë Plakë, dhe... varrin e gjyshit tim të shtrenjtë. Tufani kishte fytyrën më shnerëzore të planetit. Mjerë ne!..

Rrugica ime jetoi edhe pas këtij tufani të çmendur. Të moshuarit agjëronin. Po ashtu edhe të moshuarat. Në heshtje e fshehtësi. Por edhe moshat më të reja. Ndoshta, por kjo ishte e vërtetë: Donin që të mos e humbnim besimin në Fenë Islame. Edhe kështu... veç të jetonte, që të jetonin: dëshirat, fëmijëria, morali, virtytet dhe ëndrrat tona. Dhe fëmijëria ime mbeti e bukur, sepse ishin të gjithë këto personazhe që përmenda në shkrimin tim, të cilët u kujdesën me dashuri dhe urtësi, i dhanë besim e moral. Faleminderit!..

Shkodër, korrik, 2015

Prindërit e mi, pas një jete në lagjen “Perash”, erdhën e u vendosën në lagjen “Zdralej”. Nuk e di pse ndodhi kjo gjë. Si në eter, sikur... kam dëgjuar..., se ishte dëshirë e babait. Ndoshta, ngaqë jetonim pakëz në periferi... dhe duhej t’i afroshim qendrës. Shtëpinë e Velahalilve që blemë, i kujtoj ato burra: njëri më zotni se tjetri...

... atëhere unë isha shtatë vjeç. Vetë kisha lindur në lagjen “Perash”. Ende, edhe sot e kësaj dite, e kujtoj atë shtëpi të vjetër dykatshe. Më kujton fëmijërinë. Gjithçka më kujton...: edhe bahçen me plot pemë, dritaren që ishte përballë dhe shihja vetëm gjelbërim, lule vilet që mbulonin derën e vjetër, pusin me çikrik, shokun tim të fëmijërisë, Habilin,... Ngaqë i kujtoj shpesh; gjurmët e kësaj moshë të largët, era e mallit më ftojnë herë pas here... Paçka se sa herë që shkoj: ca pika loti më ndalen në faqe... Mوندohem t’i fshijë e nuk fshihen dot...

Tani, në këtë lagje të re, në këtë rrugicë të kësaj lagjeje, do të kaloja një pjesë tjetër të fëmijërisë, më vonë edhe të rinisë, si dhe të një pikëlimi boreal të thinjave të para; më pas, me keqardhje edhe të një fillimi të rënies së flokëve...

Dy rreshtat e shtëpive që formonin rrugicën, për nga mënyra e ndërtimit arkitekturor ishin tipike shkodrane. Ishte një lagje e qetë, e pazhurmë dhe besimtare.

Tani, këto rradhë që po shkruaj, i mësova, si informacion, me kalimin e viteve. Në fillim të rrugicës, në të djathtë të saj jetonte Hafiz Qazim Rakaj. E kam njohur shumë mirë at’ burrë! Fisnik. Shumë rrugë e biseda

“ZIDNÍ”, LIBRI MË I RI NGA IMAM MUHAMED B. SYTARI

Ramazani e sivjetshëm, doli në qarkullim libri: “Zidnî”, një punim i Myftiut të Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Libri në fjalë është një përmbledhje me studime islame, ese, intervista dhe mesazhe të autorit, të cilat janë punuar në harkun kohor: korrik 2013 – dhjetor 2014.


Libri, në 255 faqet e tij, është ndarë në pesë kapituj, ku autori është përpjekur të pasqyrojë realitetet e përditshme, me të cilat përballet Thirrja Islame në Shkodër, Shqipëri dhe në rrafsh global, si dhe mesazhet përkatëse, që ai jep në raport me situatë dhe aktualitetin e jetuar.

Në këtë libër, autori, ndër të tjera, ka hedhur dritë mbi tema të larmishme teologjike, ku ka sjellë njohuri dhe argumente të dobishme mbi Kur’anin Famëlartë (f. 15-20), jetën dhe misionin e Hz. Muhammedit (a.s), si mëshirë e dhuruar (f. 32-48), sakrificën dhe modelin e sahabëve në përkushtimin e tyre ndaj të dërguarit të All-llahut (f. 21-31), mbi jetën dhe veprën e Imam Bukhariut (f. 49-54), sikurse risjell në vëmendjen tonë argumente dhe dëshmi të rëndësishme mbi jetën e dijetarit islam të Shkodrës, H. Halid Bushati (f. 55-68).

Në parathënien e librit, teksa shpjegon arsyet e titullit të këtij libri, ndër të tjera, autori thekson se: [“Zidnî”, në fakt, është një lutje dhe kërkesë e shtrenjtë, që duhet të shoqërojë çdo mysliman në përditshmërinë e marrëdhënies së tij me jetën, me veten, me tjetrin. “Zidnî”, është një lutje e shtrenjtë, të cilën All-llahu Mëshirëplotë, ia mësoi më të Dashurit të krijesave të Tij, Hz. Muhammedit (a.s), të cilin e udhëzoi të lutej: “... dhe thuaj: “Zoti im, më shto dituri!” (Kur’ani, TâHâ: 20:114).

Po, sepse, në jetën tonë të përditshme, ne kemi nevojë pikërisht për këtë lutje: “Zidnî” (më shto!), në raportet tona me dijen dhe vlerat e saj, sidomos kur përballemi me padijen, me antivlerat, me tendencat e ndryshme,

që mundohen të përmbysin kupat e arsytetimeve të drejta dhe ideve të goditura, me mendimet e devijuara dhe ato ngacmuese, (që nga njëra anë mundohen të legjitimojnë imoralitetin në mendim e në të shprehur e, nga ana tjetër, përpiqen të sfidojnë heshtjen e zërit tonë si myslimanë në shoqërinë tonë (përtej realiteteve të ngushta të xhamisë), që ka kohë që dëgjohej stonueshëm?!), sepse sikurse kanë thënë të moçmit tanë: “Librat (këtu, dija) janë kështjellat e të mençurve,



“Zidnî”, në fakt, është një lutje dhe kërkesë e shtrenjtë, që duhet të shoqërojë çdo mysliman në përditshmërinë e marrëdhënies së tij me jetën, me veten, me tjetrin. “Zidnî”, është një lutje e shtrenjtë, të cilën All-llahu Mëshirëplotë, ia mësoi më të Dashurit të krijesave të Tij, Hz. Muhammedit (a.s), të cilin e udhëzoi të lutej: “... dhe thuaj: “Zoti im, më shto dituri!”

ku mbrohen dhe lulishtat e të urtëve ku shëtisin”!

Realitetet tona janë nevojtarë për më shumë dije, për më tepër urtësi e, mbi të gjitha, për më tepër vullnet për t’u lutur me zemër “Zidnî”, në rrugën e ndërtimit dhe mbrojtjes nga prekjet e errësirës së padijes! – (f.10).

Libri në fjalë, vjen pas një sërë botimesh të autorit, si: “Opinione bashkëkohore islame” (2002), “Përpjekje të dështuara” (2003), [Hap pas hapi me “Udhën Islame”] (2004), “Përhapni për mua, qoftë dhe një fjalë...” (2006), “Kujtime dhe refleksione të një Ramazani” (2007), “Ve alejkes-selam...” (2008), “Rrugëtime të një hatibi” (2009), “Dhe kthehet kjo hëna e re e Ramazanit...” (2009), “Vehbi Sulejman Gavoçi- Dijetar nga dijetarët e ymmitit” (Prishtinë, 2005), “Hafiz Qamil Tresi- Në gjurmët e një biblioteke, që sfidon heshtjen e kohës...” (2006), “Hafiz Musa Hoxha- Vaizi besnik i qitabeve të vjetra” (2009), “Faik Hoxha para pasqyrës së një jete...” (LOGOS-A, 2011), si dhe është autori i bibliografisë: “Bibliografi “Udha Islame” 50 numrat e parë” (2007) etj.

Në prill të vitit 2013, me rastin e tre vjetorit të drejtimit të Myftinisë Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari ka botuar librin me titull: “Nún Pasha Lapsin...”, ndërkohë, në dhjetor 2013, boton librin më të ri të titulluar: “Dëshmitar në Sahar”.

Libri “Zidnî”, i botuar nga Sh.b. “Focus print”, Shkup, Maqedoni, ka për redaktor shkrimtarin Xhahid H. Bushati. Ndërkohë, kopertina e librit është përgatitur nga kaligrafi i shquar tunizian, Sami Gharbi.

Autorit i urojmë suksese dhe mbarësi në botimin e librave të rinj, në dobi të lexuesit dhe në pasurim të bibliotekës islame në gjuhën shqipe.

Ferzet Ndoja

Shkodër, 5 gusht 2015

Sa herë kaloj në lagjen Garuc dhe vështroj vendin e vakëfit të saj, aty ku dikur kishte një xhami, më vjen ndër mend Hoxha, i bardhi Hoxhë...

Nuk më hiqet nga mendja insistimi i tij i vazhdueshëm; në takime të drejtpërdrejta, me letra, me telefonata, në të gjitha format...

H. Vehbi S. Gavoçi, u dishru për ta rindërtuar atë xhami të vogël, ku dekada më parë kishte shërbyer si imam e hatib, i ati, H. Sulejman Gavoçi... Në fund të fundit ajo ishte edhe xhamia e lagjes së tij, aty afër kishte shtëpinë e vjetër, ku ishte lindur e ku kishte kaluar fëmijërinë e parë, derisa një ditë...

Në një prej atyre ditëve, kur fëmijëria burrërohet dhe kujtimet e saj barten në valixhet e udhëtimeve të gjata pa kthim, larg shtëpisë, larg lagjes, larg xhamisë, shokëve e mësuesve, vendlindjes e të dashurve..., larg, pa kthim...

Në një prej atyre ditëve, pasi H. Sulejmani kishte vendosur të emigronte për hir të Zotit, për të ardhmen e fëmijëve të tij, teksa shihte se në sfondet e largëta të Shkodrës e të mbarë Shqipërisë, errësira dhe njerëzit e saj, ishin bërë të gati të vërshonin me tërë fuqitë e tyre... Dhe, historia vërtetoi se ashtu ishte, ashtu ndodhi, ashtu vazhdon të jetë...

Nga ajo ditë e derisa mbylli sytë (në vitin e afërt 2013), Hoxha nuk e harroi xhaminë e lagjes, mihrabin e babës së dashur, minberin, prej ku zëri i tij kumbues, tamam si në ato ditë, kur dilte në llogoret e mbrojtjes së qytetit kundër malazezëve, thërriste pa pushim për besim, shpresë, dritë, të ardhme e qëndrueshmëri... Nuk e harroi xhaminë e lagjes Garuc, i bardhi Hoxhë...

Më kujtohet edhe ajo ditë, kur, me porosi të Hoxhës, kisha mbërritur para derës së Myftinisë Shkodër, për të biseduar me vetë Myftiun. Isha bartës i një amaneti të madh nga Hoxha... Asokohe isha student në Damask. Isha kthyer për pushimet e verës. Kujtoj se në takim, te Myftiu, një dëshirë e madhe për kryerjen e amanetit dhe finalizimin e tij më kishte pushtuar. Mezi prisja të mbaronte biseda e jonë me një pohim a miratim të Myftiut, ndonëse ajo ende nuk kishte filluar... (Më vonë do më rezultonte se ajo ishte e mbaruar, që pa filluar)...

Më kujtohet sesi Myftiu, pasi i komunikova se Hoxha më kishte nisur me një amanet, kërkesën për ndërtimin e asaj xhamie të shtrenjtë për të dhe kujtimet e tij, nga fondet e familjes, thirri administratorin (një person që nuk

NUK E HARROI XHAMINË E LAGJES GARUC, I BARDHI HOXHË...

ia kujtoj as emrin, as më intereson t'ia kujtoj tani), i cili, si ta kishte shabllon të gatshëm përgjigjen, e mbylli pa e hapur mirë si bisedë...

I heshtur e pa fjalë, dola nga ajo zyrë, duke menduar se çfarë do t'i thoja Hoxhës... Si do ia komunikoj përgjigjen e marrë në myftini? T'i thoja se një pjesë toke e ka zënë filani e një pjesë tjetër shteti? Aty ka ndërtuar iksi, ndërsa ypsiloni ka nisur procedurat për të legalizuar një llokme më tutje? Apo t'i thoja se...? Çfarë t'i thoja?

Pamundësia e myftinisë asokohe, për t'i dhënë drejtim kësaj kërkesë, ishte një dhembje më shumë, që i shtohet përgjigjes negative dhe faktit, se xhamia e shumëdëshiruar, ndoshta nuk do të ndërtohej më në atë vend... Ose, të paktën, kështu përktheheshin fjalët, letrat dhe realiteti i dëshmuar mbi tokën-letër e fakteve konkrete-bojë e zezë...

Pastaj, teksa vështroj një dyqan të madh para syve të mi, tamam mbi vakëfin e xhamisë, më kujtohet poshtërsia e një ish-drejtori të ALUIZNI-t Shkodër, që pas shumë gjarpërimesh, i legalizoi të afërmit të tij atë objekt, pengesë për rikthimin e vakëfit të shenjtë në shenjtërinë e tij dhe legjitimitetin e mohuar...

Poshtërsi, po, po, poshtërsi! E di mirë, se një thirrësi islam nuk i shkon të përdorë këtë zhargon fjalësh, por disa realitete të hirta në qytetin tim të deformuar, nuk mund të përkthehen ndryshe, vetëm se me një numër të caktuar fjalësh, që shpesh, edhe pse nuk na pëlqen t'i themi, jemi të detyruar, jashtë vullnetit...

Më kujtohen tërë këto dhe mendoj me vete sesa harame janë akumuluar në këtë vend, ku dikur burëria e besimit, geni islam dhe trashëgimia e vlerave familjare tregoheshin me gisht, si nishan, ndërsa sot... dhe, më dhemb..?!

Mendoj me vete se sa harami futet në barqet e hallkut, pa pyetur për origjinën, burimin, pasojat..?! Sa familje jetojnë mbi toka të zaptuara, mbi ish-varreza muslimane, mbi troje të shenjta, që nuk janë të tyret, as mund të jenë, edhe pse një ligj vjedhacak, a një branci bashkëkohore, ia ka legjitimuar...

Mendoj me vete, se sa të shumtë janë ata, që mezi presin të vishen edhe me rrobat e fetarizmit, si kameleonë a kllounë cirqesh, si e si të zhvasin diçka jo të tyren; diku një dyqan vakëf, diku

një tokë vakëf, pale se nuk kanë asnjë të drejtë, pale se është HARAM, pale se harami të del për hundësh!

Dhe, Zot na ruaj, sa të dhimbshëm që e ka harami fundin, në këtë botë para ahiretit, sidomos, kur të vijnë ndër mend ajete e hadithe të panumërta, që tërheqin vëmendjen e secilit për t'u ruajtur në jetë dhe për të mos shkelur hakun e tjetrit... Sepse tjetri, kur të preket haku i tij, kthehet në person të shkelur, në njeri që i është bërë zullum...

Dhe, për këtë kategori njerëzish; të shkelurit që i është bërë zullum, i Dërguari i Zotit thoshte: "Ruaju lutjes së atij që i është bërë padrejtësi, se në mes saj dhe All-llahut, nuk ka perde!"¹

Ndjej dhembje pa fund për të gjithë... Sidomos për zullumqarët! Dua të udhëzohen, të kthehen nga harami i shkeljes së vakëfit të shenjtë, nga arroganca primitive dhe injoranca e shkeljes aty ku nuk u takon, e s'u ka takuar asnjëherë!

Lutem me zemër... Por, kjo lutje dhe kjo dëshirë, në vetvete nuk janë shenjë thyerje, as tërheqje, JO, pasha hakun e Zotit!

Ato, në fakt, janë një betim personal dhe një angazhim institucional (sa të jem në krye të këtij institucioni që përfaqësoj), për të mos u ndalur asnjëherë përpara këtij modeli zullumqarësh, për të mos toleruar asnjëri, që i ka marrë kryti erë dhe mendon se vakëfet janë han pa portë dhe mall pa zot!

Dhe ndalem për një moment dhe vështroj një foto të Hoxhës... Nëpërmjet buzëqeshjes së tij marr forcë dhe kurajo për të ecur përpara, i bindur më shumë se kurrë, se në rrugën e kthimit të së drejtës së dhunuar, do të kesh përherë mbrojtjen e Zotit dhe bekimet e Tij...

Ndërsa zullumi, e ka dritën e shkurtër. Në fakt, drita e tij nuk ndriçon, nuk ka ndriçuar, as ka për të ndriçuar kurrë!

Dhe, sërish më kujtohet Hoxha, që asnjëherë s'e harroi xhaminë e lagjes Garuc, derisa ndërroi jetë i dishruem për një prekje kujtimi të shkelur e të mohuar, padrejtësisht... I bardhi Hoxhë... I bardhi kujtim... E shkelura Xhami...

Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, më 17 gusht 2015

1. Transmetuar nga Bukhari.



Arben Halluni, teolog

Vizita e Shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush nuk e beson (nuk e viziton) All-llahu nuk është i nevojshëm për (adhurimin) që bëjnë njerëzit.”¹

Haxhi si një nga obligimet dhe shtyllat kryesore të Islamit është bërë i detyrueshëm për ata që kanë mundësi fizike, mendore dhe materiale në vitin e nëntë hixhri (kalendarit hënor islam). Përveç argumentit kur'anor për obligimin e haxhit, edhe hadithi profetik i të dërguarit të fundit, Muhammedit (a.s) sjell faktin e obligimit mjaft të rëndësishëm të kësaj shtylle islame: “Feja Islame është ndërtuar mbi pesë shtylla: Shehadeti (deklarata islame), kryerja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi dhe **haxhi**”. Sipas traditës profetike duhet të kryhet sa më herët në moshë, është një borxh për ata që kanë mundësi ta kryejnë.

Muslimani i të gjitha kohërave duhet ta kuptojë se një obligim tillë sjell përfitim individual në të dy botët (të përkohshmen dhe të Ahiretin).

Përfitimi individual, kur bashkohet me atë social arrin qëllimin më të përkryer që ka në vetvete haxhi, si shembulli në namazin me xhemat, për të cilin Pejgamberi (a.s), ka thënë: “Namazi me xhemat është më i pëlqyer se namazi vetëm, në raportin 27 me 1 (në aspekt të shpërblimit)...”.

Obligimi i haxhit ka vlera dhe urtësi të panumërta, ku mund të përmenden disa:

1. Rrugëtimi për në vendet e shenjta gjatë ditëve të haxhit na kujton rrugëtimin për në Ahiret, në takimin e përhershëm me Krijuesin e gjithësisë.

2. Në shumicën e kohës njeriu përjeton në këtë botë të dy jetët:

1. Kur'ani, El-Bekare: 197.


KUJTESË RRETH HAXHIT...

Dynjanë dhe Ahiretin. Por, vjen një kohë e volitshme, që është të paktën një herë në jetë dhe i përkushtohet vetëm jetës shpirtërore, të cilën e gjen të përngjashme me Ahiretin e përhershëm, gjatë riteve të haxhit në vendet e shenjta.

Haxhiu në këtë dynja është më afër se kurrë Madhnisë së Allahut (xh.sh) me duatë e lutjet e tij të singërta. Pa mëdyshje dua ja e besimtarit në ditët e haxhit është në nivelin më të lartë të pranimit. “Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (ta dijnë) se Unë jam pranë, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t'i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë

të drejtën e shpërblimit. Ata do të meritojnë nga Unë që t'i mëshiroj në këtë dynja dhe t'i fali kur do t'i takoj në jetën tjetër”.

3. Largimi i haxhiut prej veprave të ndaluara gjatë kohës sa është i veshur me ihram dhe përkujtimi i vazhdueshëm i emrit të Allahut (xh.sh), ia përkujton gjendjen që ai duhet të jetë. Kjo është një lloj sprove në aspektin e edukatës islame, ku mëson shpirtin të jetë në vendin më të lartë të tij të devotshmërisë, besimit dhe moralit. Haxhiu gjatë këtyre ditëve privohet edhe nga gjërat e lejueshme si në rastin e agjërimin gjatë muajit të madhëruar të Ramazanit. Në këtë mënyrë ai do ta ketë më të lehtë si gjatë haxhit ashtu edhe pas tij t'i largohet gjërave të ndaluara. Në këtë kontekst,



të drejtë.”²

Në një tjetër pjesë kuranore thuhet: “Zoti juaj ka thënë: Lutuni Mua, se do t'ju përgjigjem”.³ “Ai u përgjigjet lutjeve të atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira e u jep edhe më tepër prej dhuntisë së Vet...”⁴ Ndërsa nga tradita profetike mund të përmendet hadithi i transmetuar nga Ebu Dherri (r.a) se i Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: “Profeti Daud (a.s) ka thënë: O Zoti im! Çfarë do të kenë ato që do të vizitojnë shtëpinë Tënde? Allahu (xh.sh) thotë: Çdo vizitor do të ketë

2. Kur'ani, El-Bekare: 186.

3. Kur'ani, Gafir: 60.

4. Kur'ani, Esh-Shura: 26.

Allahu (xh.sh) thotë: “Kush vendos të kryejë haxhillëkun, le të largohet nga marrëdhëniet (me gruan), grindjet dhe sharjet...”⁵

Konform këtij verseti kur'anor, Pejgamberi (a.s), thotë: “Kush kryen haxhin dhe gjatë riteve të tij largohet nga marrëdhëniet intime bashkëshortore dhe nga grindjet, do të kthehet i pastër prej mëkateve, si në ditën që e ka lindur nëna e tij”⁶.

4. Shkuarja në Qaben e madhnueshme është përjetim qetësie dhe sigurie për haxhiun. Kjo gjendje shpirtërore me të gjitha elementët e saj kujton të njëjtin

5. Kur'ani, El-Bekare: 197.

6. Transmetuar nga Buhariu.

përjetim në ditën e takimit me Allahun (xh.sh). “Për ata që besojnë dhe nuk e përziejnë besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari), pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar”.⁷

5. Gjatë sjelljes-tavafit rreth Qabesë, haxhiu përkujton babain e profetëve, Hz. Ibrahim (a.s), i cili sipas historisë islame ndërtoi shtëpinë e parë të Allahut (xh.sh), Qabenë dhe ftoi njerëzit për vizitën e saj. Në këtë Shtëpi adhurimi u vendosën bazat dhe parimet e shëndoshta të vizitës së saj, të zhveshura nga çdo lloj politeizmi.

6. Ecja e shpejtë Sa’ji, në mes Safasë dhe Mervesë. Haxhiu përkujton sprovimin dhe durimin e Haxheres, nënës së Hz. Ismailit dhe gruas së Ibrahimit (a.s).

7. Qëndrimi në Arafat, pa të cilin sipas traditës profetike, nuk ka haxh, përkujtohet tubimi i madh i krijesave të Zotit Fuqplotë në Ditën e Gjykimit.

8. Në gjuajtjen e gurëve njeriu edukon vetveten për adhurim të drejtë e të vërtetë, për të cilin është krijuar dhe betohet se nuk do t’i ndjekë cytjet e shejtanit të mallkuar, të cilat prishin besimin dhe rrënojnë personalitetin e tij si besimtar.

9. Pirja e ujit të Zemzemit, haxhiut ia përkujton begatitë e Krijuesit të gjithësisë. Atë e pijnë miliona njerëz prej mijëra vitesh dhe akoma nuk është shteruar.

10. Bërja kurban e njeriut përkujton ngjarjen historike të Ibrahimit (a.s) me të birin e tij, Ismailin (a.s), i cili shprehu gatishmërinë e tij për ta therur të birin, pas ëndrrës që kishte parë. Por, All-llahu (xh.sh) e zëvendësoi me bërjen kurban të një kafshe, si bindje ndaj urdhrave të Zotit (xh.sh), sakrificë në jetë dhe gatishmëri për heroizëm në mbrojtjen e jetës, fesë, atdheut, nderit, pasurisë dhe përhapjes së paqes në mesin e të gjithë njerëzve dhe krijesave të tjera të Krijuesit.

Është pyetur Resulull-llahu, Profeti i fundit (a.s) se cila është vepra më e pëlqyer?

Ai (a.s) ka thënë: “Besimi në Allahun dhe në të dërguarin e Tij”. Pastaj është pyetur sërish se çfarë vjen pas saj? Ka thënë: “Përpjekja në rrugën e Allahut”. Përsëri është pyetur se çfarë vjen pas saj? Ai Zotni ka thënë: “Haxhi i pranuar, i cili nuk ka shpërblim tjetër, vetëm se xhennetin...”

7. Kur’ani, El-Enam: 82.

MYFTIU I SHKODRËS PRITI STUDIUESIN ISLAM MR. AHMED MEHMEDI



Pasditën e së xhumasë, më 31 korrik 2015, mbërriti për një vizitë në Shkodër, një delegacion i Forumit të Rinjve Muslimanë, me qendër në St. Gallen të Zvicrës.

Në krye të delegacionit ishte studiuesi islam, Mr. Ahmed Mehmedi, drejtori i përgjithshëm i FRM, që shoqërohej edhe nga

kryetari i FRM, z. Mustafa Saliu, shefi i Qendrës për Kërkime dhe Studime Islame, z. Sulejman Iljazi etj.

Pas faljes së namazit të akshamit në xhaminë e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, pasi uroi të pranishmit për adhurimin e kësaj nate të re, vlerësoi vizitën e studiuesit islam, Mr. Ahmed Mehmedi, si dhe delegacionit të Forumit të Rinjve Muslimanë, nga Gostivari, me banim dhe aktivitet në St. Gallen të Zvicrës.

Myftiu tha se kjo është një natë e mirë dhe një vizitë plot mall e vlera vëllazërore e diturore. Ai vlerësoi kontributin e Mr. Ahmed Mehmedit dhe tha se është në nderin e Myftinisë Shkodër ta ketë si mik të saj.

Ndërkohë, një fjalë përshëndetëse e mbajti edhe Hoxha i nderuar, Mr. Ahmed Mehmedi, i cili shprehu

kënaqësinë e tij për këtë vizitë në Shkodër. Ai tha se është shumë e rëndësishme të kuptojmë vlerën e madhe të takimeve në mesin e muslimanëve shqiptarë nga të gjitha trevat e tyre, si një familje e madhe besimi dhe vlerash kombëtare.


Njëkohësisht vlerësoi pritjen dhe ngrohtësinë e besimtarëve në Shkodër.

Vizita vazhdoi edhe në zyrën e Myftiut, ku vizitorët u njohën me një historik të shkurtër të aktivitetit të Myftinisë Shkodër në 25 vitet e fundit.

Myftiu tha se përtej persekutimit fetar që pësuan muslimanët në periudhën e errët ateisto-komuniste, besimi triumfoi dhe rrezatoi paqe dhe qëndrueshmëri përballë fortunave të femohimit, që nuk janë ndalur ndonjëherë.

Më pas, delegacioni i FRM, së bashku me Myftiun dhe bashkëpunëtorët e tij zhvilluan një shëtitje në pedonalen e Bashkisë së qytetit dhe më pas kryen edhe faljen e namazit të jacisë me xhemat, në xhaminë “Ebu Bekër”.

Pas namazit u zhvillua edhe një bashkëbisedim me këshilla fetare dhe lutje të përbashkëta vëllazërore.



Shejkh Vehbi S. Gavoçi

Hz. Osmani ishte bamiirës i madh dhe ndihmonte njerëzit e varfër, që pëlqenin fenë Islame.

Një vit nuk ra shi, njerëzit u shtrënguan, saqë tregtarët u detyruan të sjellin ushqime nga jashtë, nga vendet e tjera.

Disa njerëz erdhën te kalifi dhe u ankuan për gjendjen kritike që po kalonte populli. Ai iu përgjigj duke u thënë të pritnin pak, se Zoti (xh.sh) do t'u lehtësonte gjendjen.

Zotëri Osmani, si tregtar kishte blerë nga Siria aq shumë mall, sa kishte nevojë populli dhe e kishte transportuar me 1000 deve.

Kur arriti karvani i madh afër Medines, u përhap lajmi aq i kënaqshëm. E morën vesh tregtarët se është karvani i hz. Osmanit, prandaj lakmuan për të blerë prej tij sa më shumë mall që ta shisnin me fitim.

Tregtarët erdhën tek ai dhe i propozuan që ta shesë mallin me 20% fitim, por refuzoi, duke u thënë se i kishin dhënë më tepër. Tregtarët të çuditur e pyetën: Kush të ka dhënë më tepër, ne të gjithë jemi tregtarët e Medines?

Hz. Osmani iu përgjigj: Zoti (xh.sh) më ka premtuar 10 fish fitim për të mirën që do të bëj, pra, të jeni dëshmitarë se i gjithë karvani me mall do t'u shpërndahet nevojëtarëve të Medines gratis dhe kërkoi prej tregtarëve të hapin dyqanet e tyre edhe natën për t'u dhënë ushqime njerëzve që kërkojnë e kanë nevojë.

Hz. Osmani ishte tregtar, prandaj nuk kishte kohë për të qenë përherë pranë kalifit Ebu Bekër ose pranë kalifit të dytë, Ymerit, megjithatë ata dhe të tjerët e respektonin.

HZ. OSMANI (R.A) NË KOHËN E KALIFATIT TË EBU BEKRIT

HZ. OSMANI KALIF

Kalifin Ymer (r.a), para se të vdiste, e pyetën sahabet, nëse ishte dakord për të lënë në vend të tij Abdullahin, djalin e tij. Ai refuzoi, megjithëse i biri ishte i aftë. Ai tha se, -që kur vdiq Profeti (a.s), prej dhjetë sahabeve kanë mbetur gjashtë vetë. Ishte i kënaqur me ta, mbasi ishin të aftë, prandaj le të zgjidhnin njërin prej tyre. (Ata ishin Osmani, Aliu, Ebu Ubejde, Abdurrahmani, Saidi, djali i Zejdit, Talha Sead, djali i Vek-kasit (r.a) Të gjashtë ngarkuan Abdurrahmanin të caktojë cilin pëlqente prej tyre dhe ata do ta pranonin. Ai studioi jetën e secilit dhe pyeti popullin cilin pëlqente më tepër. Njerëzit preferuan hz. Osmanin për të qenë kalif.

Kështu pra, të hënën, ditën e fundit të muajit Dhul-hixhe (muaji i fundit në 1 kalendarin Islam), në vitin 23 të emigrimit u zgjodh hz. Osmani kalif mbas dy shokëve të vet. Të parën ditë të vitit të ri u zgjua kalif në moshën 68-vjeçare.

DISA PUNË NË JETËN E TIJ SI KALIF

Hz. Osmani qe i pari kalif, i cili i caktoi rrogë muezinit për ezanin, e shtoi një ezan ditën e xhumasë, një orë para kohës së të falurit, me qëllim që njerëzit të përgatiten për të falur xhumanë.

Qe i pari që u kërkoi tregtarëve për të ndarë zeqatin në muajin e parë të vitit të ri, në Muharrem dhe caktoi tokët e shtetit për interesat e shtetit.

Shkonte në haxh për çdo vit, për të qenë afër atij tubimi të madh. Merrte me vehte edhe gratë e Profetit (a.s), siç veptoi hz. Ymeri para tij.

Zgjodhi Xhud-den për të qenë moto e popullit dhe e tregtisë, siç është edhe sot.

Zmadhoi Xhaminë e Qabes, bleu disa shtëpi afër saj e i bëri oborr të xhamisë. Mbas një viti zmadhoi xhaminë e Profetit (a.s).

Përmendet në histori se puna e parë që bëri Profeti (a.s), sa erdhi në Medinën e ndritshme, qe ndërtimi i xhamisë së tij, pastaj ndërtoi disa

dhoma pranë saj, të cilat qenë banesa e tij me familjen.

Mbasi u kthye ai Zotëri nga Khajberi, d.m.th. mbas 7 vjetësh, u shumuan sahabet e nuk i zuri më xhamia. Atëherë Profeti (a.s) e zmadhoi përsëri xhaminë e vet.

Disa njerëz erdhën te z.Osmani dhe iu ankuan se nuk po i zinte më xhamia, kur tuboheshin për t'u falë në të, veçanërisht ditën e xhuma.

Hz. Osmani hipi në minber të Profetit (a.s) e tha: Kam dëgjuar Profetin (a.s) duke thënë **“Ai i cili ndërton xhami për hir të Zotit (xh.sh), i ndërton Zoti (xh.sh) një ndërtesë në xhenet”**, pra, unë dua ta bëj këtë gjë, siç ka bërë vetë Profeti (a.s), mandej edhe hz. Ymeri (r.a).

*“AI I CILI NDËRTON XHAMI
PËR HIR TË ZOTIT (XH.SH),
AI I NDËRTON
NJË NDËRTESE NË XHENET”*

Populli pëlqeu kërkesën e dëshirën e tij, u rrënuar thujse krejt xhamia e Profetit (a.s), mandej u ndërtua rishtas me gurë të bukur, me 110 kut gjatësi dhe 150 kut gjerësi (1 kut = 66 cm).

Mbas hz. Osmanit xhamia e Profetit (a.s) u zmadhua disa herë nga Sulltan Abdyl Mexhidi, nga mbreti Saud e nga Mbreti Fahd, vitet e fundit.

Zgjerimi i xhamisë nga hz. Osmani filloi në Rebiulev-vel në vitin e 29-të, ku punoi edhe vetë, mbasi qëndronte në xhami ditë e natë. Mbas 9 muajsh, në vitin e 30-të u plotësua ndërtesa e madhe për atë kohë.

SHKROI KUR'ANIN

Ai e përmbledhi Kur'anin e shpërndarë në pëlhura, gurë, gjethe të hurmave, eshtra e të tjera mjete shkrimi të kohës.

Në kohë të hz. Osmanit u caktua detyrë të shkruhej Kur'ani në disa

kopje, në mënyrën që e lexoi vetë Profeti (a.s) pak para se të vdiste, me qëllim që të përhapej leximi i mbarë. Kështu hz. Osmani, si Ebu Bekri më përpara, formoi një këshill nga dijetarët më të shquar. Kjo ndodhi në vitin e 30-të. Kështu u shkrua me rregull Kur'ani që përdoret edhe sot e u shpërnda në qytete të mëdha si: në Damask, Kufe, Misir etj., u la një kopje në Medine. Prej atyre kopjeve shkroi kush deshi mus'hafe për vete e për të tjerë e kështu u përhap Kur'ani në anë të afërta e të largëta, pa as më të voglin ndryshim.

Këtë punë të hz. Osmanit e pëlqyen sahabet, saqë edhe vetë hz. Aliu tha: Po të isha kalif do të bëja çka bën hz. Osmani (r.a).

Në kohën e tij u munduan çifutët të ngjallin ngatërresa ndërmjet muslimanëve, për të rrëzuar qeverinë Islame.

Çifuti Abdullah, djali i Sebeit, e pëlqeu në dukje fenë Islame. Ai gjeti disa shokë si vetja, të tjerë lakmues të të ardhurave, mundën të gjejnë edhe disa të rinj Islamë. Hz. Osmani ishte i butë e nuk pranonte të ndëshkonte e të arrestonte kënd, të përzinte kënd nga vendi i punës së tij, gjë që u bë shkak më vonë për ta mbytur atë burrë të ndershëm e të madh, baba i dy dritave, siç e pat quajtur herët Profeti (a.s).

Ky burrë i madh u akuzua në fund qartas për disa gjëra, të cilat i përgënjeshtroi me fakte, saqë vetë kritikuesit pranuan fjalët e tij e u penduan, por jo çifuti me shokë.

Në një mbledhje të madhe me akuzuesit e tjerë tha: Keni thënë se unë kam falur drekën në Mina me katër reقاتë, kurse Profeti (a.s) me dy kalifet e kanë falur në dy reقاتë, si udhëtarë që kanë qenë. Unë jam martuar në Mekte, kam familje aty, pra nuk njihem udhëtar, atëherë duhet ta fali drekën me katër reقاتë.

Disa njerëz thanë se kam zënë për vete një tokë të popullit për bagëti e nevoja të mia. E vërteta është se unë heret kam pasur dhen e deve, më vonë nuk lashë gjë, sot nuk kam, atë tokë e kam zënë për njerëzit që kanë bagëti, që kullosin e pushojnë atje.

Disa të tjerë kanë thënë se kam marrë nga buxheti i shtetit, e vërteta është se unë tash 12 vjet që sundoj, nuk kam marrë rrogë mujore, jo më të marr e të vjedh nga buxheti e arka e shtetit.

Ka thënë dikush se unë kam mbledhur njerëzit e kam djegur disa musafë të mangët që ishin të disa njerëzve. Unë këtë gjë nuk e bëra vetëm, të gjithë sahabet pëlqyen këtë sjellje që të mos kujtojë kush një ditë se musafi i mangët është musafi i vërtetë, mbasi sahabet kanë shkruar për vete çka kanë pasur nevojë për të mësuar përmendsh e për të përsëritur, e disa pjesë që këndoheshin për ditë, nuk i kanë shkruar, mbasi nuk harrohen, etj.

Thonë se kam bërë disa gjëra që nuk janë bërë përpara. E vërteta është se kam pasuar hapat e Ebu Bekrit e të Omerit, nuk kam bërë gjë nga vetja.

Dikush thotë se kam vënë në punë djem të rinj. Është e vërtetë, po ata janë të aftë, të mençur, të pëlqyer. Pyeteni popullin për ta, e nëse kanë pasur të meta, ata janë përgjegjës.

Vetë Profeti (a.s) ka emëruar disa të rinj në punë të mëdha, mbasi ishin të aftë. Vuri në Meke si prefekt At-Tabin, djalin e Esidit, që ishte veç 20 vjeç dhe emëroi Usamën, djalin e Zejdit, komandant ushtarak në luftën kundër romakëve, që nuk ishte veç 18 vjeç.

Të mëdhenjtë i thanë se këta janë të vërteta, se njerëzit flasin, pse nuk dinë të ruhen nga shpikësit e gënjeshtreve.

Po thonë disa, se unë e dua familjen time edhe i jap asaj pasuri. Është e vërtetë, unë e dua familjen time, mirëpo ajo nuk më ka shtyrë për të lënë e për t'iu shmangur drejtësisë, kurse çka kam dhënë për ta, ajo ka qenë prej pasurisë sime. Unë kam dhënë e kam ndarë shumë të holla për nevojat e popullit, për luftëra të ndryshme e tani që u plaka e po mbaron jeta ime, flasin gjëra jo të vërteta.

Ju, tha, e dini se, kur u përgatita për të luftuar romakët, dhashë për luftë 3000 napolona e gatova 1000 vetë me nevojat e luftëtarit. Për këtë Profeti (a.s) ka thënë: Pëlqej Osmanin e punën e tij, edhe Ti Zot (xh.sh) pëlqeje.

Ju e dini se unë bleva pusin (Rume) e lashë kohë të caktuar për muslimanët, që të përfitojnë, prej atij ujë gratis e se Profeti (a.s) pat thënë: Kush e blen pusin (Rume), ka xhenet te Zoti (xh.sh).

Njerëzit pohuan thëniet e hz. Osmanit. Atyre iu zbutën zemrat si dhe atyre që e kritikuan ashpër një ditë, mandej u shpërndanë.

Mirëpo mbas disa ditësh me intriga

“Thonë se kam bërë disa gjëra që nuk janë bërë përpara. E vërteta është se kam pasuar hapat e Ebu Bekrit e të Omerit, nuk kam bërë gjë nga vetja.”

e gënjeshttra të tjera erdhën përsëri të larguarit nga vendet e tyre, derisa rrethuan hz. Osmanin në shtëpinë e vet dhe e ndaluan të dalë për t'u falë në xhami të Profetit (a.s) si kalif që ishte.

Burrat e Medines, hz. Aliu e të tjerë dërguan fëmijët e tyre që të ruajnë shtëpinë e hz. Osmanit që mos të mundet kush të hyjë brenda dhe kujtuan se mbas pak ditësh ata kryengritës do të ktheheshin si tradhtarë për në vendet e tyre. Kështu do të mënjanoheshin gjakderdhja ndërmjet anëtarëve të një feje.

Kryengritësit, tradhtarët, armiqtë e fesë, të nxitur nga çifutët e të tjerë, hynë në shtëpi të hz. Osmanit nga tarraca e ngjitur me shtëpitë e tjera, zbritën e grabitën çka gjetën, mandej hynë në dhomën e plakut 82-vjeçar, i cili ishte vetëm, pa armë, kishte mus'haf para tij, lexonte në të dhe pranë tij gruan e vet.

E mbytën. Iu derdh gjaku përpara, derisa ra mbi musafin që ai lexonte.

Kjo jetë është jetë pune e jo shpërblimi, jeta tjetër është jetë shpërblimi e jo pune. I lumi ai që bën mirë në jetën e punës për jetën e shpërblimit ku s'ka punë. Pra, duhet të mos habitemi, të mos mendojmë keq, se kjo jetë është kalimtare, secili punon në të çka i pëlqen e do, por i mjeri ai që pëlqen të keqen, e do, e bën dhe e zbaton atë!

Profeti (a.s) ka thënë: **“Zoti vonon të dënojë tiranin, absolutin që bën ç'do, por kur e ndëshkon, e merr me fuqi e nuk e lëshon kurrë.”**¹ Ne dimë se Zoti (xh.sh) ndëshkon njerëzit e vendet e këqija për mëkatet e liga, por kur ndëshkon, e ka gazepin pikëllues e të fortë.

1. Muslim

NJË DITË PLOT DRITË, NGA GJURMËT ISLAME TË SHKODRËS...



Ditën e shtunë, më 1 gusht 2015, për nder të vëllezërve të Forumit të Rinjve Muslimanë, nga Zvicra dhe Austria, të cilët ndodhen për vizitë në Shkodër nga dita e djeshme, Myftinia Shkodër kishte përgatitur një program të larmishëm.

Programi nisi me faljen e namazit të sabahut në xhaminë e re të “Dy Vajzave”, që me kërkesë të Myftiut, Imam Muhamed Sytari, u drejtua nga Drejtori i përgjithshëm i FRM, Mr. Ahmed Mehmedi.

Më pas, Myftiu bëri një përshkrim të historisë së vakëfit të vjetër të Shaban efendisë dhe historinë e ndërtimit të këtij kompleksi bashkëkohor islam, që

mban emrat e dy vajzave kuvajtiane, “Sara dhe Shehd”...

Më pas, vëllezërit vizituan edhe xhaminë e re të lagjes Dudas, ku shprehën kënaqësinë e tyre për këtë ndërtim të bukur, që e hijeshon Shkodrën duke u bërë një gjurmë tërheqëse drejt vlerave islame të këtij qyteti dhe banorëve të tij.

Pas sofrës së mëngjesit, ku u këmbyen urime, lutje dhe dhurata simbolike, u vijua me vizitën e disa vendeve historike islame të qytetit, ku spikat vizita e xhamisë së kalasë së Shkodrës dhe e muzeut të saj.

Gjatë kësaj vizite, u theksua se gjurmët shekullore islame në Shkodër

janë që para periudhës osmane, por në atë periudhë të artë, ato lulëzuan dhe morën hov edhe më tepër.

Mr. Ahmed Mehmedi, shprehu kënaqësinë e tij të madhe për vizitën e bërë në xhaminë shekullore të kalasë së Shkodrës dhe theksoi se kjo gjurmë e shtrenjtë duhet të ketë vëmendje të përqendruar, me qëllim rikonstruksionin e saj dhe shfrytëzimin edhe për qëllime adhurimi, si në të shkuarën.

Vizita vazhdoi edhe pranë zonës së xhamisë së Plumbit dhe gjurmëve të xhamisë së Qafës.

Pjesë e këtij programi në nder të vëllezërve të FRM-së ishte edhe biseda e z. Kujtim Dervishi, drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, i cili bëri një përshkrim të arritjeve të deritanishme të Medresesë së Shkodrës, si një shkollë elitare në rang kombëtar.

Vizitorët u ndalën edhe tek përmendorja e komandant Hasan Riza Pashës, si një simbol i shtrenjtë i Shkodrës dhe kontributit historik të muslimanëve të saj në mbrojtje të Shkodrës nga rrethimi malazez i vitit 1913.

Pas një pushimi të shkurtër, pas drekës së sotme, vëllezërit e FRM-së e mbyllën vizitën në Shkodër, me përshtypjet më të mira dhe me dëshirën e takimeve të tjera, që forcojnë ndjenjat vëllazërore dhe rrisin bashkëpunimin e ndërsjellët.



MYFTIU, LIGJËRATË ME NJË GRUP STUDENTËSH TË FRI, MAQEDONI

Pasditën e së shtunës, më 1 gusht 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, zhvilloi një ligjëratë fetare me temë: “Muslimani, model udhëzimi në jetë”, me një grup studentësh të Forumit Rinor Islam, nga Shkupi i Maqedonisë.

Në këtë vizitë të bërë ditën e sotme, grupi i studentëve drejtohej nga z. Fevzi Musliu, Kryetar i FRI, si dhe nga z. Hasan Baftijari, nën/kryetar i FRI.

Pas faljes së namazit të iqindisë me xhemat, Myftiu ka uruar kryetarin dhe nën/kryetarin e FRI, Shkup, për vizitën në Shkodër.

Në një ligjëratë të mbajtur për grupin e studentëve të pranishëm, Myftiu ka folur mbi modelin e dijetarëve të shkuar të Shkodrës, në shfaqjen e modelit më të mirë të udhëzimit drejt dijes dhe mirësisë në jetë.

“Teksa flas për një elitë të caktuar të dijetarëve shkodranë, por jo vetëm, në rrugën e udhëzimit dhe qënies së tyre si busulla udhëzimi për tjetrin në jetë, dua të tërheq vëmendjen tuaj se muslimani është njeri i ditur, që nuk e humb kohën



e tij me angazhime pa dobi.

Muslimani është njeri dashamirë ndaj tjetrit, kushdo qoftë ai, sepse njeriu është vëlla i njeriut, sikurse na mëson edhe zotëria i jonë, Hz. Muhammedi (a.s).

Dua të përmend shembullin e disa prej hoxhallarëve tanë, të cilët ishin shëmbëlltyra e mësimëve dhe udhëzimeve të Hz. Muhammedit (a.s.) në jetë. Natyrshëm, ju nuk jeni studentë teologjie, ju nuk do të bëheni hoxhallarë, por ju duhet të angazhoheni maksimalisht për të justifikuar

përkatësinë tuaj fetare, me dinjitet dhe me krenari legjitime, nëpërmjet arritjeve tuaja në dije nga degët që keni zgjedhur.

Ju, përtej të gjithave, keni mundësinë të jeni modeli i muslimanit të suksesshëm, me veprën tuaj, me shembullin e edukatës dhe moralit tuaj, me fjalën e mirë dhe etikën e komunikimit në jetë”, - tha ndër të tjera Myftiu.

Ligjërata është pasuar me këndimin e ilahive të bukura dhe një pjese kur'anore nga dy studentë të përzgjedhur të FRI, që e zbkuruan edhe më shumë këtë takim vlerash.

MYFTIU PRITI DREJTORIN E ALUIZNI, Z. ARTAN LAME

Ditën e enjte, më 6 gusht 2015, Myftiu i Shkodrës, priti në një takim pune, Drejtorin e Përgjithshëm të ALUIZNI-t, të Republikës së Shqipërisë, z. A. Lame. Në takim, u diskutua mbi vlerën e madhe që kanë pronat e shenjta vakëf për Myftininë Shkodër, si dhe nëpërkëmbjen e madhe që u është bërë këtyre pronave në dekadat e fundit.

Myftiu vlerësoi vizitën e z. Lame dhe e konsideroi atë si një moment të rëndësishëm, për nisjen e fazës përfundimtare të legalizimit të plotë të krejt xhamive dhe medreseve, mbi tokat e tyre legjitime.

Nga ana e tij, Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, z. Artan Lame, vlerësoi se pronat e Myftinisë Shkodër dhe të krejt komuniteteve fetare, duhen respektuar dhe duhen kthyer në identitet.

Ai tha se procesi i legalizimit duhet të ishte mbyllur me kohë, por ky proces do të konkretizohet i plotë, aq më tepër në rastin e xhamive të reja, që sipas të dhënave të sakta, janë ndërtuar mbi gjurmët e xhamive të shkuara, pa



shkelur në prona të huaja.

Me rastin e këtij takimi, z. Lame i dorëzoi Myftiut të Shkodrës, procedurën e përfunduar të legalizimit të dy xhamive, duke theksuar se ky proces sapo ka nisur dhe se së shpejti do të vijohet me plotësimin e plotë të kërkesave të depozituara nga Myftinia Shkodër.

Ndërkohë, në prani të mediave të pranishme, Imam Muhamed Sytari theksoi se, pavarësisht faktit se nga viti

2006, Myftinia Shkodër ka depozituar të gjithë dokumentacionin e plotë për legalizimin e rreth 60 objekteve të saj, marrja e këtyre dy dokumenteve, mbetet një shenjë pozitive që duhet vlerësuar. “Shpresoj dhe lutem, që deri më 16 nëntor 2015, ditën e 25 vjetorit të ripahjes së xhamisë së Plumbit, të ketë përfunduar edhe legalizimi i plotë i krejt xhamive dhe medreseve të Shkodrës.”, - tha Myftiu.

PRONAT VAKËF, MYFTIU FLET PËR "VOA"



Në një intervistë për “Zërin e Amerikës”, të enjten, më 6 gusht 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, theksoi se sekuestrimi i pronave të Myftinisë së Shkodrës dhe mbarë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, në vitin 1967, ishte një goditje e madhe dhe e rëndë për Islamin dhe

muslimanët në vendin tonë.

Ai tha, se përtej kësaj, peripecitë e hasura gjatë 25 viteve të demokracisë, janë të panumërta, sa vetë numri i dosjeve të Myftinisë Shkodër, vakëfeve të patrajuara ende, që e kalojnë numrin 100 dhe akoma kanë ngelur në pluhur në sirtaret e institucioneve shtetërore.

Gjatë kësaj interviste, Myftiu tha se nga viti 2006 e deri më sot, Myftinia Shkodër ka depozituar pranë ALUIZNI-t, Shkodër, rreth 60 dosje, për legalizimin e plotë të krejt xhamive dhe medreseve të saj.

Myftiu vlerësoi vizitën e sotme të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t të Republikës së Shqipërisë, z. Artan Lame dhe dorëzimin e dy procedurave të miratuara, duke e konsideruar këtë si një fillim të mbarë deri në përfundimin e plotë të këtij procesi të gjatë e të vështirë.

Myftiu theksoi se vonimi i deritanishëm në kthimin e pronave dhe legalizimin e objekteve, ka ndikuar edhe në financimin e Thirrjes Islame në Shkodër.

“Kthimi i plotë i pronave tona legjitime dhe shfrytëzimi i duhur i tyre, do të rregullonte përfundimisht edhe financimin e imamëve dhe Thirrjes Islame në vendin tonë”, - tha Myftiu.

U INAUGURUA ÇEZMJA E XHAMISË SË PARRUCËS

Ditën e xhuma, më 14 gusht 2015, pas faljes së namazit të xhumasë në xhaminë e Parrucës, u zhvillua ceremonia e inaugurimit të Çezmes së Xhamisë së Parrucës, një bamirësi komunitare e besimtarit H. Besnik Elbasani.

Pas falënderimeve të bëra nga hytbeja e xhumasë për këtë vepër të mirë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, teksa ndante ujin me të pranishmit dhe bamirësin, H. Besnik Elbasani, theksoi se kjo vepër është një gjurmë e pastër, që përkthen shpirtin e fesë islame; ndihmën dhe solidarizimin në komunitet.

Myftiu thashë Islami është jetë, tamam si ky ujë, që gjallëron nevojtarët e tij. “Kjo bamirësi vjen në kohën e duhur, për të thënë se Islami është feja e jetës, e respektimit të mirësive të Zotit, e solidaritetit me njerëzit



dhe e kontributit për të mirën në komunitet”, - tha Myftiu.

U falënderua bamirësia e familjes Elbasani dhe u bënë lutje për mbarësinë e tyre.

Myftinia Shkodër falënderon dhe shpreh mirënjohjen e saj për këtë

vepër të dobishme komunitare të Haxhi Besnik Elbasanit me djem, sikurse lutet për shtimin e shembujve të bamirësisë në komunitet, në Shkodrën e traditave islame dhe gjurmëve të bamirësisë së muslimanëve të saj.

MYFTIU PRITI KRYETARIN E AAIS, Z. VAHID GOGA

Ditën e hënë, më 17 gusht 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, z. Vahid Goga, Kryetar i Shoqatës Islamike Shqiptare Australiane (AAIS), me qendër në Melburn të Australisë.

Gjatë kësaj vizite të përzemërt, z. Vahid Goga e njohu Myftiun e Shkodrës me aktivitetin e AAIS në Australi, që daton nga viti 1963, kur muslimanët shqiptarë ndërtuan xhaminë e parë në Australinë e largët.

Ai tha se muslimanët shqiptarë në Australi kanë organizimet e veta, sidomos me rininë, ku vlen të përmendet bashkëpunimi në mes shoqatave dhe xhamive shqiptare atje, si dhe hapja e një qendre të re rinore.

Me rastin e kësaj vizite, z. Goga e prezantoi Myftiun edhe me revistën «Drita Islame», botim i AAIS, në gjuhën shqipe dhe atë angleze, ku prezantohen aktivitetet e larmishme të AAIS.

Nga ana e tij, Imam Muhamed Sytari, shprehu kënaqësinë e tij për këtë vizitë, duke vlerësuar aktivitetin



e AAIS, si një djep i shquar edukimi i brezave të shumtë muslimanë shqiptarë në Australi.

Myftiu tha se muslimanët shqiptarë, kudo që janë, e kanë për detyrë ta shtojnë bashkëpunimin në mes vete, si një pikënisje drejt dëshmimit të vlerave të tyre fetare dhe kombëtare, kudo në botë.

Ai e prezantoi mikun e tij me

aktivitetin e gjerë të Myftinisë Shkodër, botimet e saj të larmishme dhe përgatitjet për 25 vjetorin e rihapjes së xhamisë së parë pas lejimit me ligj të lirisë së fesë.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe rreth sfidave të ndryshme, me të cilat përballlet bashkësia islame në Shkodër, Shqipëri dhe mbarë trojet shqiptare në këtë kohë.

MYFTIU PRITI DREJTORIN E SHOQATËS “XHAMIA IMAM EL-BUHARI”, VJENË

Paraditën e së martës, më 18 gusht 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, z. Taulant (Daud) Kurtabegu, drejtor i përgjithshëm i Shoqatës Humanitare Kulturore Shqiptare në Vjenë (Austri) - “Xhamia Imam El-Buhari”.

Gjatë këtij takimi, Myftiu shprehu falënderimet e tij në drejtim të z. Kurtabegu, për bashkëpunimin dypalësh me Myftininë Shkodër, sidomos për projektet e dobishme të realizuara, sidomos atë të shpërndarjes së përkthimit të kuptimeve të Kur’anit në gjuhën shqipe, gjatë muajit Ramazan, iftaret vëllazërore në oborrin e xhamisë “Ebu Bekër”, ndihmën ndaj nevojtarëve etj.



Dy bashkëbiseduesit diskutuan edhe për realitetin e Thirrjes Islame në Shkodër dhe Vjenë, si dhe obligimin e madh që kanë muslimanët për prezantimin e mësimave të fesë

nëpërmjet shembullit personal dhe shoqërisë së mirë me tjetrin.

Me rastin e kësaj vizite, Myftiu e ftoi teologun Taulant (Daud) Kurtabegu, të mbajë një hytbe xhumaje këtë javë.

Ditën e mërkurë, më 19 gusht 2015, pas namazit të mesditës në xhaminë e Parrucës, Myftinia Shkodër organizoi një tribunë fetare, ku i ftuar special ishte studiuesi islam, Mr. Muhidin Ahmeti, imam i Qendrës Islame “Mesxhid el-Resul”, Wels, AUSTRI.

Në krye të herës, teologu Arben Halluni, theksoi se emri i studiuesit islam Muhidin Ahmeti, është i mirënjohur në Shkodër, për kontributin e madh, që ai ka dhënë për tetë vite me radhë, në vitet e para të rimëkëmbjes islame, pas vitit 1990.

Ai theksoi se ligjëratat e sotme është një mundësi e mirë për të dëgjuar një trajtesë të përzgjedhur rreth një teme me vlerë për kohën dhe aktualitetin e botës islame.

Në ligjëratën e tij, Mr. Muhidin Ahmeti, pasi falënderoi Shkodrën dhe shkodranët për mikpritjen dhe bashkëpunimin e frytshëm, për tetë vite, vlerësoi se koha e kaluar në Shkodër, ishte një periudhë e mrekullueshme e jetës së tij, në shërbim të Thirrjes Islame.

Mr. Muhidin Ahmeti trajtoi një temë bashkëkohore që lidhet me angazhimin e muslimanëve për të dalë nga rutina e të jetuarit pa mendim, pa arsytim, pa zemër, pa thellim në dije, pa fuqi e pa përvetësim të shkaqeve të forcës e unitetit në jetë.

“ME ÇFARË T’I MAHNISIM TË TJERËT?”, LIGJËRATA NGA MR. MUHIDIN AHMETI



Në ligjëratën e tij, përmendi ajete dhe hadithe që tërheqin vëmendjen e muslimanëve drejt arsytimit dhe zgjimit të thellimit për të kuptuar si duhet fenë dhe rolin që duhet të kenë muslimanët në jetë, për t’i dhënë kuptim asaj, me moralin islam dhe virtytet e thellimit në dije e shkencë.

Aktivitetin e përshëndeti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili falënderoi ligjëruesin e nderuar, Mr. Muhidin Ahmeti, për temën e dobishme të mbajtur para të pranishëmve dhe

emocionet e përcjella.

Me rastin e kësaj ligjërata, Myftiu i dhuroi z. Ahmeti, një ndër botimet e reja të KMSH, “Bibliografia e gazetës “Drita Islame”, Janar 1992 – Dhjetor 2011”.

Me shumë emocion, të pranishmit dëgjuan edhe falënderimin dhe mirënjohjen që znj. Fahire Ahmeti, bashkëshortja e Mr. Muhidin Ahmetit, lexoi, duke shprehur përjetimet e saj gjatë tetë viteve të jetuara në Shkodër dhe emocionet e ndarjes prej saj, me rastin e largimit, para 15 viteve.

MYFTIU BASHKËBISEDOI ME STUDIUESIN ISLAM, MR. MUHIDIN AHMETI



Ditën e mërkurë, më 19 gusht 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, studiuesin islam, Mr. Muhidin Ahmeti, pas ligjëratës që ai mbajti në xhaminë e Parrucës, në aktivitetin e zhvilluar nga Myftinia Shkodër, ditën e sotme.

Në takim, Myftiu, pasi falënderoi Mr. Muhidin Ahmetin, për ligjëratën e tij të

dobishme, tha se është e domosdoshme që xhematet dhe muslimanët në përgjithësi, të përballen me trajtesa intelektuale, që thyjnë tabutë e ligjërimit të sotëm fetar dhe rutinën e përditshme me të cilën ata përballen. Ai tha se muslimani i sotëm duhet të dalë nga rutina e përditshme, duke u thelluar edhe më shumë në arsytimet fetare, për ta kuptuar fenë dhe për t’u thelluar

në kuptimet e saj të mrekullueshme.

Ndërkohë, Mr. Muhidin Ahmeti foli edhe për eksperiencën e tij pozitive në Austri, ku theksoi se shteti e respekton fenë, lënda e edukatës fetare është pjesë e kurrikulave të arsimit shtetëror atje, sikurse dha informacione të dobishme mbi ligjin e ri mbi fetë, të miratuar nga qeveria austriake dhe organizimin e Bashkësisë Islame të Austrisë.

Bashkëbisedimi u soll edhe rreth aktualitetit të botës islame dhe Thirrjes Islame në përgjithësi, sikurse u diskutua edhe rreth botimeve dhe dobisë së tyre për komunitetin.

Të pranishëm në këtë bashkëbisedim, ishin edhe z. Ardit Hoxhllaku, Myftiu i Tepelenës, z. Alban Kali, kryeredaktor i revistës “Etika”, si dhe z. Lavdrim Hamja, kryeredaktor i gazetës “Udha Islame”.

Për nder të kësaj vizite, Myftiu i Shkodrës, shtroi një drekë falënderimi.

MYFTIU PRITI KRYETARIN E BASHKËSISË FETARE ISLAME TË ITALISË, MR. RESHAT IBISHI

Ditën e xhuma, më 21 gusht 2015, pas namazit të xhumasë në xhaminë e Parrucës, ku mbajti edhe hytben, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të ngrohtë e vëllazëror, Mr. Reshat Ibishin, Kryetar i BFI të Italisë, me qendër në Mantova.

Në këtë takim, z. Ibishi shoqërohej edhe nga z. Eljasa Mahmudi, imam në Kumanovë dhe studiuesi i shquar, z. Elez Ismaili.

Kësaj vizite, iu bashkua edhe një delegacion besimtarësh nga Turqia, të drejtuar nga Hafiz Emin Arik, ish-Myfti i qytetit Bodrum, i cili drejtoi edhe namazin e xhumasë së sotme në xhaminë e Parrucës.

Gjatë këtij takimi vëllazëror, Myftiu i njohu vizitorët e nderuar me historikun e Myftinisë Shkodër, ku theksoi se sivjet përkujtohet 25 vjetori i lirisë së besimit në Shkodër dhe mbarë Shqipërinë. Njëkohësisht i prezantoi vizitorët edhe me disa prej botimeve të reja të Myftinisë Shkodër



në kuadër të aktiviteteve që përkojnë me këtë datë të rëndësishme.

Nga ana e tij, Mr. Reshat Ibishi, e informoi Myftiun për aktivitetin e BFI të Italisë në Mantova, ku sivjet do të përkujtohet 10 vjetori i formimit të kësaj qendre të rëndësishme islame të shqiptarëve atje.

Myftiu falënderoi edhe miqtë nga

Turqia, të cilët i uroi për këtë vizitë të këndshme dhe vëllazërore, sikurse pranoi urimet dhe lutjet e tyre më të mira për mbarësinë e punës dhe aktivitetit të Myftinisë Shkodër.

I pranishëm në këtë takim ishte edhe Dr. Genti Kruja, drejtor i kulturës në KMSH, si dhe një grup imamësh të Myftinisë Shkodër.

U ZGJODH KËSHILLI I RI I MYFTINISË SHKODËR



Paraditën e së hënës, më 24 gusht 2015, u zhvillua takimi i imamëve dhe përfaqësuesve të këshillave të xhamive të ndryshme, me të cilët Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, diskutoi rreth zgjedhjes së Këshillit të ri të Myftinisë Shkodër.

Fillimisht, Myftiu informoi të pranishmit mbi të dhënat e statutit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë mbi procedurat për zgjedhjen e këshillave të myftinive.

Myftiu theksoi se bazuar mbi statutin dhe rregulloren e brendshme

të KMSH, personat e propozuar për antarë të Këshillit të ri të Myftinisë Shkodër, karakterizohen me cilësitë e duhura dhe formimi intelektual dhe besimor, si dhe kontributet në fusha të ndryshme të jetës.

Pas prezantimit të kandidaturave, Myftiu ftoi të pranishmit të japin mendimet e tyre, në prag të zgjedhjes.

Pas diskutimeve dhe mendimeve të dhëna, u procedua me votimin e Këshillit të ri, që u miratua nga të përzgjedhurit e këshillave të xhamive të Shkodrës.

Së shpejti, Myftiu do të thërrasë Këshillin e ri të Myftinisë Shkodër, në takimin e parë zyrtar të tij. Mandati i Këshillit të Myftinisë është 4 vjet dhe ai mblidhet për të diskutuar problematikat e ndryshme të Myftinisë Shkodër, ato të Thirrjes Islame e më gjerë.

MYFTIU PRITI THIRRËSIN ISLAM, H. BURHAN FILI



Paraditën e së martës, më 25 gusht 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt, thirrësin islam, H. Burhan Fili, me banim në Michigan dhe veprimtari të gjerë në ShBA dhe përtej tyre.

Fillimisht, Myftiu ka shprehur kënaqësinë e tij për këtë vizitë të z. Burhan Fili, të cilin e ka falënderuar për kontributin e tij, sidomos në fillimet e rimëkëmbjes së Thirrjes Islame në Shkodër e Shqipëri, pas vitit '90.

Nga ana e tij, thirrësi islam, H. Burhan Fili, ka falënderuar Myftiun dhe bashkëpunëtorët e tij për angazhimet e tyre në shërbim të aktivitetit të larmishëm islam në Shkodër. Ai ka kujtuar me emocion, momente nga bashkëpunimi me të nderuarit, Imam Vehbi Ismaili dhe Shejkh Vehbi Sulejmani, në kuadër të ndihmës për ripërtëritjen e Thirrjes Islame në

Shkodër, në vitet e para të rilejimit me ligj të fesë.

Ai ka këshilluar që bashkëpunimi të jetë sa më i madh, i gjerë dhe gjithëpërfshirës, në dobi të përhapjes së vlerave islame në qytetin e Shkodrës.

Më pas, bisedat e ngrohta janë përqendruar te aktiviteti botues dhe përgatitjet e Myftinisë Shkodër për përkujtimin sa më dinjitoz të 25 vjetorit të rihapjes së xhamisë së parë, pas ndryshimeve politike në vendin tonë, në vitin 1990.

Me këtë rast, Myftiu e ka ftuar thirrësin islam, H. Burhan Fili, për të qenë pjesë e këtij përkujtimi, si pjesë e aktiviteteve të larmishme në kuadër të këtij eventit me vlera lokale dhe kombëtare. Njëkohësisht e ka lajmëruar të nderuarin H. Burhan Fili për vullnetin e Myftinisë Shkodër, që zotëria e tij të jetë një ndër personalitetet e nderuara në këtë përvjetor jubilar.



DIJETARI NGA SIRIA: ISIS NUK ËSHTË PRODHIM I MUSLIMANËVE



Dijetari bashkëkohor, Dr. Salahudin Ahmed Keftaro, djali i dijetarit të shquar, myftiut të madh, dhe kolosit të pazëvendësueshëm nga Siria, Ahmed Keftaro, në një shënim në profilin e tij në Facebook, ka folur për luftën në Siri dhe prapavijën e ISIS-it ose siç ndryshe quhet DAISH.

Ai thotë se:

“Të çmendur dhe budallenj janë ata të rinj muslimanë që luftojnë sot Sirinë dhe Irakun, të ardhur nga mbarë bota, për t’u bashkuar me DAISH, që e quajnë veten si: Shteti Islam në Irak dhe Sham!

Këta budallenj nuk e kanë kuptuar se DAISH është prodhim izraelit, ndërsa drejtuesit e tij jehudë zionë, sikurse nuk kanë kuptuar se ai është zjarr që djeg të pafajshëm, ndërsa ata benzina e këtij zjarri!

Kur të përfundojë misioni i DAISH, do të ekzekutohen edhe ta atë rinj budallenj të mbetur dhe, asnjë prej tyre nuk do të shpëtojë, pasi ata ranë në kurthin e ngritur para tyre!”

Kohëve të fundit gjithnjë e më shumë janë duke u ngritur zërat dhe dyshimet rreth qëllimeve të “Shtetit Islamik” dhe të strukturës kryesore të kësaj organizate.

(www.islampress.info)

Pasditën e së martës, më 25 gusht 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në shoqëri të teologëve dhe imamëve të nderuar, H. Fejzi Zaganjori, Arben Halluni, Idmir Plaku, Lavdrim Hamja dhe Lulzim Beqiri, zhvilloi një vizitë në shtëpinë e Hoxhës së moshuar, H. Musa Hoxha.

I gëzuar për vizitën e Myftiut me imamë, H. Musa Hoxha, shprehu kënaqësinë e tij për këtë takim të përzemërt, që e konsideroi si shenjë respekti dhe nderimi për zotërinë e tij.

H. Musa Hoxha, iu drejtua Myftiut me imamë, me disa këshilla të dobishme dhe njëkohësisht u kujtoi atyre kohët e shkuara, me hoxhallarë të nderuar të Shkodrës, si: H. Muhamed Bekteshi, H. Sabri Bushati etj, prej të cilëve ka marrë mësim për vite. Ai kërkoi që aktiviteti i Myftinisë të jetë i vazhdueshëm, cilësor dhe nv shërbim të interesave të besimtarëve, por edhe të krejt muslimanëve, praktikantë a jo qofshin ata.

Nga ana e tij, Myftiu i Shkodrës, vlerësoi se kjo vizitë është një shenjë respekti dhe mirënjohjeje për një brez

VIZITË TE HOXHA I MOSHUAR, H. MUSA HOXHA



të nderuar hoxhallarësh, që shërbyen me përkushtim dhe nuk hoqën dorë nga shërbesat fetare as në ditë të vështira, si ato që pasuan shkurtin e vitit 1967.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu e informoi Hoxhën e moshuar për aktivitetin e Myftinisë Shkodër dhe kërkoi prej

zotërisë së tij lutje për mbarësinë e mëtejshme.

H. Musa Hoxha ka lindur në vitin 1926 dhe është i fundit i brezit të tij, si dëshmitar i gjallë i mësimëve të vyera dhe ixhazeteve nga hoxhallarët e shkuar të Shkodrës.

MBLIDHET KËSHILLI I RI I MYFTINISË SHKODËR

Pasditën e së enjtes, më 27 gusht 2015, u zhvillua mbledhja e parë e Këshillit të ri të Myftinisë Shkodër.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, uroi fillimisht anëtarët e Këshillit të ri të Myftinisë Shkodër, duke theksuar se përgjegjësitë e çdo shërbyesi të misionit fisnik të Myftinisë Shkodër dhe të Thirrjes Islame, janë të mëdha, edhe përtej sfidave me të cilat përballemi ditë pas dite.

Ai tha se detyra e Myftiut dhe e Këshillit të Myftinisë Shkodër, është angazhimi maksimal në shërbim të qëllimeve, në përmirësim të rrugëtimit dhe në respektim të udhëzimeve dhe moralit të fesë; Kur'anit dhe Traditave të Hz. Muhammedit (a.s).

Gjatë kësaj mbledhjeje të parë, u bë edhe prezantimi i secilit anëtar dhe e CV së tij, sikurse u bë edhe votimi për dy anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm të KMSH.

Gjatë kësaj mbledhjeje, Myftiu shprehu nderimin dhe respektin e tij për



anëtarët e Këshillit të kaluar, për të cilët tha se ndjehej i nderuar dhe krenar për punën e përbashkët, mirëkuptimin dhe shërbimet e dobishme të përbashkëta.

Këshilli i Myftinisë Shkodër, drejtohet nga Myftiu dhe ka në përbërje të tij:

1. Kujtim Dervishi, drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia",
2. Arben Halluni, teolog,
3. Lavdrim Hamja, imam, xhamia e "Dy Vajzave",
4. Ruzhdi Plangaj, imam, xhamia Kiras,
5. Idmir Plaku, imam, xhamia "Ebu

Bekër",

6. Altin Loshi, teolog/ekonomist,
7. Admir Temja, teolog,
8. Mit'hat Myftija, imam, xhamia e Plumbit,
9. Fejzi Zaganjori, imam, xhamia Rus,
10. Ardit Muça, inxhinier,
11. Gledian Gojashi, ekonomist,
12. Artur Tagani, teolog.

Në fund të mbledhjes, u bë edhe një lutje për mbarësinë dhe suksesin e Këshillit të ri të Myftinisë Shkodër.




المشيخة الإسلامية الألبانية
دار الإفتاء - مدينة شُكُودِرا
KOMUNITETI MUSLIMAN I SHQIPËRIË
MYFTINIA SHKODËR



*"Në Islam,
mendimi ballafaqohet me mendim,
ndërsa dyshimi me argument.
Për këtë, nuk ka detyrim në fé,
as sforcim në arsyetim,
as dhunë në Thirrje!"*

Shejkh Jusuf El-Karadavi

(President i Unionit Botëror të Dijetarëve të Muslimanëve)



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja
Dizajn & Grafik:
Bledar Xama

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org